



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:126699

Datë: 04.12.2020

Numri i dokumentit: 01319233

P.nr.712/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurit N. K nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1471/20, të datës 28.09.2020, jashtë seancës dhe sipas detyrës zyrtare, me datë 04.12.2020, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim me numër Nd..... e datës 03.11.2020, e lidhur në mes të pandehurit N.K dhe përfaqësuesit të të dëmtuarës KEDS-Distrikti në Gjilan, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-ës.
- II. HUDHET poshtë aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.II.nr.1471/2020, e datës 28.09.2020 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit N.K nga fshati ..., Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-ës ngase i pandehuri dhe përfaqësuesi e të dëmtuarës kanë arritur marrëveshjen për ndërmjetësim.
- III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 02.10.2020, ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1471/2020, kundër të pandehurit N.K nga fshati ... Komuna e Gjilanit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 1 të KPRK-ës.

Me datë 03.11.2020, pranë zyrës për ndërmjetësim në këtë gjykatë është arritur marrëveshja me numër Nd....., sipas të cilës i pandehuri i kërkon falje palës së dëmtuar dhe njëherit dëmin e

shkaktuar në vlerë prej 208.20 € ia ka paguar në tërësi derisa pala e dëmtuar është tërhequr nga ndjekja penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike.

Andaj gjykata duke u bazuar në të lartcekurat si dhe në bazë të nenit 358 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe paragrafi 2 të KPP-së dhe nenit 2, 4, 8, 14, të Ligjit mbi Ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.712/2020, me datë 04.12.2020

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.